ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KRU"BIFURKACIONI"SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **600-KRU"BIFURKACIONI"SH.A.-24-1345-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Digjitalizimi i shërbimeve**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**PBC SH.P.K.**
NUI	**810845985**
Adresa	**Rr.Idriz Gjilani p.n.**
Vendi	**Prishtina**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Bashkim Selmani**
Adresa elektronike	**bs@pbc.group**
Data e parashtrimit të ankesës	**21.06.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Digjitalizimi i shërbimeve

Njoftimi për Kontratë: 23.02.2024

Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara: 07.03.2024

Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara: 08.04.2024

Dorëzimi i ofertave: 22.04.2024

Njoftim mbi vendimin e Autoriteti Kontraktues: 07.06.2024

Kërkesa për rishqyrtim: 11.06.2024

Vendimi ne kërkesën për rishqyrtim: 13.06.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kërkesën për rishqyrtim e kemi dorëzuar me date 11.06.2024

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 54 i Ligjit për Prokurim Publik (këtu e tutje: LPP)
Neni 62 i LPP
Neni 59 i LPP
Neni 64 i LPP
Paragrafi 7 i Nenit 43 të Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022 për Prokurim Publik (këtu e tutje: RRPP)
Paragrafi 2 i Nenit 44 të RRPP
Neni 52, paragrafi 1, nënparagrafi 5 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (këtu e tutje: LPPA)
Neni 108/A i LPP

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues (këtu e tutje: AK), Bifurkacioni SH.A., në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 07/06/2024 për anulimin e aktivitetit të prokurimit, e rrjedhimisht me Vendimin për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim të datës 13/06/2024, për tenderin me titull "Digjitalizimi i shërbimeve" dhe me numër "600-KRU "BIFURKACIONI" SH.A.-24-1345-2-2-1", me vetëdije ka bërë shkelje flagrante të dispozitave ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (këtu e tutje: LPP),, dhe gjithashtu, Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022. Më poshtë, po i elaborojmë dispozitat ligjore të shkelura:

a. Neni 54 i Ligjit për Prokurim Publik (këtu e tutje: LPP)
b. Neni 62 i LPP
c. Neni 59 i LPP
d. Neni 64 i LPP
e. Paragrafi 7 i Nenit 43 të Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022 për Prokurim Publik (këtu e tutje: RRPP)
f. Paragrafi 2 i Nenit 44 të RRPP
g. Neni 52, paragrafi 1, nënparagrafi 5 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (këtu e tutje: LPPA)
h. Neni 108/A i LPP.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik (këtu e tutje: OE), se AK ka bërë shkelje flagrante të LPP për arsyet si më poshtë:

1. Për të ruajtur autenticitetin e Kërkesës për Rishqyrtim, pra për të mos dalë nga obligimi ligjor se Ankesa duhet të jetë e njejtë me Kërkesën për Rishqyrtim, kërkojmë mirëkuptim nga OSHP në ankimimin dhe atakimin edhe të Vendimit për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim të datës 13/06/2024, ku AK **duke mos respektuar dispozitat ligjore të prokurimit publik,** mundohet të na vë neve në **lajthitje**, edhe ju si OSHP për faktin se kinse oferta jonë është në kundërshtim me nenin 59.4. Pra, në 3 faqe volum të Vendimit të datës 13/06/2024, AK nuk ka dhënë asnjë arsyetim logjik e as ligjor, por ka përshkruar kërkesën tonë për rishqyrtim, dhe me një paragraf të vetëm ka dhënë arsyetimin e saj, **duke mos shtjelluar asnjë nga pretendimet tona, e duke mos arsyetuar veprimet dhe vendimet e saj**. I rikujtojmë AK-së se, sipas dispozitave ligjore të nenit 108/A, paragrafi 12, **e njëjta KA OBLIGIM LIGJOR** që të arsyetoj vendimin e saj. Andaj, me qenë se AK nuk ka shqyrtuar pretendimet tona në Kërkesën për Rishqyrtim, të njëjtat, por të elaboruara, po i shtjellojmë në këtë ankesë.

2. Vendimi i datës 07/06/2024 është i kundërligjshëm sepse është nxjerrë në kundërshtim me bazën ligjore që AK ka specifikuar. AK e ka arsyetuar vendimin e saj sipas dispozitave ligjore të neneve 43.7 dhe 44.2 të RRPP. Neni 43.7 thotë se: ""Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme: të gjithë tenderet e përgjegjshëm përmbajnë çmim që e tejkalojnë buxhetin e AK."
Ndërsa, Neni 44.2 thotë se: "P*ërdorimi i formularëve standard – do të thotë se dokumentet e prokurimit duhet të përmbajnë të paktën të gjitha informatat, kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përcaktuara në formularët standard si informacion të detyrueshëm, dhe në përgjithësi të jenë të qartë dhe të kuptueshme për OE të interesuar*."
Pra, kjo bazë ligjore e vendimit të AK nuk përkon me dispozitivin e vendimit i cili është: "KRU Bifurkacioni ShA, anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin, operatorët ekonomik janë të papërgjegjshëm.
Pra, siç shihet, **AK përmes një baze ligjore të gabuar dhe një arsyetimi të paqëndrueshëm në fakte dhe prova, nxjerrë një vendim të kundërligjshëm.**

3. Vendimi i datës 07/06/2024 është në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 62 të LPP. Kjo dispozitë ligjore specifikon në mënyrë të kjartë, taksative dhe decidive arsyet se kur anulohet një procedurë prokurimi. Ndërsa arsyetimi dhe baza ligjore e vendimit të AK-së është në kundërshtim me këto dispozita ligjore. Pra, **AK anulimin e kësaj procedure e ka bërë duke anashkaluar kufizimet dhe dispozitat imperative të nenit 62 të LPP-së.**

4. Me Letren Standarde te Kërkesës për Sqarime Shtesë, datë 16/05/2024, **AK vepron në mënyrë arbitrare dhe kundërligjshme ka shkelur nenin 52, paragrafi 3.** Kjo sepse, përmes këtyre sqarimeve, AK **devijon kërkesat dhe kriteret e DT**. Devijimi i këtyre kritereve, rrjedhimisht edhe tjetërsimi i tyre del në pah sepse, me kërkesën për sqarimet shtesë të datës 16/05/2024, **AK kërkon që përvojen e punës ta dëshmojmë përmes TRUST**, ku kërkesa e dosjes se tenderit për përvojën e pune ka qenë "***përvoja e punës të dëshmohet me anë të referencave të punëdhënësve***". Ndersa për poziten "Zhvillues i bazës së të dhënave" kërkohet certifikatë për zhvillues (Developer) në MS SQL Server, ku

kerkesa e dosjes se tenderit për Zhvillues i bazës së të dhënave kërkesa në dosje të tenderit ka qenë "***të jetë i çertifikuar në MS SQL Server***". Ne si OE kemi vepruar përshtatshmërisht kërkesave të DT-së. Pra, siç shihet, AK në mënyrë flagrante dhe arbitrare vepron në kundërshtim me par. 3 të nenit 52, duke ndryshuar substancialisht kriteret e kualifikimit.

Provë: Fq. 16 dhe 17 e DT
Provë: Oferta jonë
Provë: Letra Standarde e Kërkesës për Sqarime Shtesë e datës 16/05/2024, dhe
Provë: Përgjigja jonë në letrën standarde të datës 18/05/2024

5.AK, vazhdon që në mënyrë arbitrare të veproj kundërligjshëm me dispozitat ligjore të nenit 52, par. 3, ashtu që dërgon prap Letrën Standarde për Sqarimet Shtesë të datës 27/05/2024, me kërkesën e njëjtë për certifikimin e Zhvilluesit të bazës së të dhënave, duke u munduar të arsyetoj këto kërkesa jashtë ligjore (me nënkuptime). **Ky veprim i AK bie në kundërshtim edhe me dispozitat ligjore të nenit 64 të LPP-s**ë, sepse AK **nuk merr në konsideratë kërkesat teknike që VETË AK ka parashtruar në DT**. Rrjedhimisht, nuk merr parasyshë certifikatat dhe referencat që OE e jonë i ka dërguar, e të cilat janë përshtatshmërisht **SIÇ ËSHTË KËRKUAR NË DT**.

Provë: Dosja e Tenderit, fq. 16 dhe 17
Provë: Oferta jonë
Provë: Letra Standarde e Kërkesës për Sqarime Shtesë e datës 27/05/2024, dhe
Provë: Përgjigja jonë në letrën standarde të datës 29/05/2024

6. Gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, AK duhet të veproj në mënyrë të plotë me dispozitat ligjore të nenit 59 të LPP-së. Oferta që ne kemi dërguar, është në përputhje të plotë me paragrafin 4 të nenit 59, ashtu që kemi dërguar të gjithë dokumentacionin e specifikuar/kërkuar në DT. Rrjedhimisht, anulimi i aktivitetit të prokurimit, përbën shkelje të dispozitave ligjore të LPP.

7. Vendimi i AK i datës 07/06/2024 është nxjerrë duke mos respektuar po ashtu edhe nenin 54 të LPP-së, sepse AK ka nxjerrë vendimin duke mos saktësuar mungesat e tenderit tonë. Kjo dispozitë ligjore, ndër të tjerash, specifikon si në vijim: "*në rast të eliminimit të një tenderuesi që është eliminuar për shkak të parregullsive ose përndryshe tenderit të papërshtatshëm, njoftimi do të saktësojë mungesat në një tender të tillë"*.

8. Duke vepruar kështu siç u spjegua më sipër, AK me veprimet dhe vendimet e saj, nuk respekton ligjin material (në këtë rast LPP dhe RRPP), e as ligjin procedural ashtu që nxjerrë një vendim të paligjshëm në këtë procedurë administrative. Meqenëse AK është organ shtetëror, e njëjta obligohet që, me rastin e përpilimit të shkresave dhe marrjes së veprimeve në procedurë, të veproj përshtatshmërisht ndër të tjerash, edhe me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPA). Ndërsa, AK, përveç që vepron në kundërshtim me LPP dhe RRPP, vepron po ashtu në kundërshtim edhe me LPA, specifikisht në kundërshtim me nënparagrafin 5, paragrafi 1 i nenit 52 (52.1.5), ku thuhet

se: Një akt administrativ i paligjshëm është nëse është në kundërshtim me ligjin material. Ligji material në rastin tonë, është LPP. Dhe, ky vendim duhet të anulohet ashtu siç kërkon në mënyrë të kjartë dispozita ligjore e nenit 54 të LPPA-së. Duke qenë situata kështu, ne si OE përmes një parashtrese, kemi kërkuar edhe anulimin e vendimit (të dt. 07/06/2024) të paligjshëm.

Provë: Kërkesa për Anulim të Vendimit të Paligjshëm

Nga sa më sipër, kërkojmë nga OSHP që të detyroj AK që të:

a) ANULOJ VENDIMIN e datës 07/06/2024
b) TË NXJERRË Vendim të ri
c) VENDIMI I RI të bëhet në bazë të vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave sipas kërkesave ligjore të Ligjit për Prokurimit Publik

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet materiale do te përcaktohen pas nje ekspertizë financiare

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*